



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:163785
Datë: 18.03.2024
Numri i dokumentit: 05466374

P.nr.813/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Fatmir Krasniqi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arbnijë Gashi, në lëndën penale, kundër të akuzuarit J.A., nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, rruga ‘.....’pn, për shkak te veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/II.nr.1242-16/22 të datës 11.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor gjyqësor, në praninë e prokurorit të shtetit Atnor Skoro, të përfaqësuesit të dëmtuarit av. F.Sh., të akuzuarit J.A., dhe mbrojtësit të tij av.V.O., , me datë 12.02.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa përpiloi me shkrim me datë 12.03.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuarit:

J.A., nga i ati dhe e ëma, mbiemri i vajzërisë së nënës, i lindur me datë, në fshatin Skorobisht, Komuna e Prizrenit, tani me banim në fshatin Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, rruga ‘.....’ pn, ka të kryer shkollimin e mesëm, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 16.06.2022, rreth orës 02:00, nga fshati Skorobisht K. Prizren, respektivisht përmes rrjeteve sociale, seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë se do ta privojë nga jeta dhe se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, me qëllim të frikësimit, në atë mënyrë që për shkak të problemeve lidhur me lidhjen e mëhershme në mes vajzës së të pandehurit, A.A., dhe të dëmtuarit B.A., i pandehuri dërgon mesazh përmes rrjetit social, duke u drejtuar me fjalët “do të të vras, do të shkatërroj jetën”, me ç`rast i pandehuri tek i dëmtuari shkakton frikë, ankth dhe pasiguri personale për jetën e tij dhe anëtarëve të familjes së tij-.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Kanosja, nga neni 181 par.2 lidhur me par.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 181 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPRK-së të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej **treqindpesëdhjetë (350,00) €**, të cilin dënim me gjobë, i akuzuari është e obliguar ta paguajë në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk mund apo nuk dëshiron ta paguajë dënimin me gjobë, atëherë gjykata, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim, respektivisht 17 ditë burgim.

Të dëmtuarin B.A., nga fshati Reqan, Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike gjykata e udhëzon në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguajë te gjitha shpenzimet e procedurës penale në bazë të llogarisë se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20,00 euro dhe në emër të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimin shumën prej 20,00 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1242-16/22 të datës 11.08.2022, kundër të akuzuarit, J:A., nga fshati Lubizhdë, Komuna e Prizrenit, rruga " "pn, për shkak te veprës penale, Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në disa seanca në të cilën in akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nga provat materiale dhe personale të cilat janë administruar gjate seancave gjyqësore dhe pas analizimit të tyre një nga një, dhe në ndërlidhje me njëra tjetrën, në tërësi është vërtetuar se këtu i akuzuari e ka kryer veprën penale objekt i akuzës. Gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar nga deklarata e të dëmtuarit, dëshmitarit B, i cili gjatë dëshmisë së tij të dhënë para kësaj gjykate, në mënyre kronologjike, bindëse dhe argumentuese, ka treguar për gjykatën ngjarjen që ka ndodhur në mes të akuzuarit, dhe ndër të tjera ka treguar se i akuzuari përmes mesazheve kërcënuese e kanosur me privim nga jeta të përshkruar si në objekt të akuzës, poashtu gjendja faktike është vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarit S.Th., , i cili është deklaruar ne lidhje me raportin e përpiluar në lidhje me thirrje telefonike nga Vala 900, që ka rezultuar se rreth ditës kritike ka pasur komunikim përveç që nuk ka mundur të nxirren mesazhet për arsyet e njohura edhe për gjykatën, se një gjë e tille nuk është e mundur sipas dispozitave ligjore për shkak se nxjerrja e mesazheve për të kaluarën nuk mund të behet, poashtu gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës është vërtetuar edhe nga dëshmitari S.A., , i cili poashtu ka treguar ngjarjen kronologjike dhe argumentuese, ka pohuar se i dëmtuari ka pasur mosmarrëveshje me të akuzuarin dhe si rrjedhoje e mosmarrëveshjeve që ka pasur i dëmtuari me të akuzuarin rreth vajzës se të akuzuarit, se i dëmtuari ka qene në lidhje me atë vajzë, por në lidhje me këtë rast i akuzuari e ka kërcënuar me mesazhe, fjalë të përshkruara si në objekt të akuzës, kjo gjendje faktike pjesërisht është vërtetuar edhe nga mbrojtja e të akuzuarit, i cili në mbrojtjen e tij të dhënë para kësaj gjykate ka pranuar faktin se edhe para rastit dhe më pas lidhjes që ka pasur vajza e tij me të dëmtuarin, janë krijuar problemet mes tyre që edhe vet i akuzuari e ka kundërshtuar fuqishëm këtë lidhje duke i dërguar mesazhe ofenduese por duke mos pranuar faktin se i ka dërguar mesazhe me

përmbajtje kërcënuese, kjo gjendje faktike përveç provave personale është vërtetuar edhe nga provat materiale të cilat janë administruar, edhe nga provat materiale dhe ato nga fotodokumentacioni ku vërehen mesazhe me përmbajtje kërcënuese poashtu edhe nga Vala 900 që ka ekzistuar thirrja telefonike në mes të akuzuarit në drejtim të dëmtuarit, prandaj nga të gjitha këto është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mire, se këtu i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, dhe për çka gjykatës i ka propozuar që të njëjtin ta shpall fajtor dhe dënoj sipas ligjit dhe me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë se dënimit të ketë parasysh si rrethane lehtësuese, qëndrimi korrekt i të akuzuarit pranë kësaj gjykate, ndërsa si rrethane rënduese të ketë parasysh faktin shkallen e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale, rrezikimin e vlerës së mbrojtur që është jeta e njeriut këtu e të dëmtuarit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe shkallen e përgjegjësies penale.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit av.F, në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështet fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, dhe qëndron pranë realizimit të kërkesës pasurore juridike dhe atë në kontest të rregullt civilo juridik.

Mbrojtësi i të pandehurit J.A., av V.O., në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se me provat materiale të administruara dëgjimin e dëshmitareve, mbrojtjen e të akuzuarit pa dyshim është vërtetuar një gjendje tjetër faktike e përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës. Në përshkrimin e dispozitivit të aktakuzës pretendohet se i pandehuri J., me dt.16.06.2022 rreth orës 02,00 të mëngjesit, i ka dërguar të dëmtuarit B., nëpërmjet rrjeteve sociale një mesazh kërcënues me fjalët: “do të shkatërroj jetën dhe do të vras”, mirëpo me provat e administruara para se gjithash është vërtetuar se në mes të palëve nuk ka pasur asnjë komunikim në bazë të rrjeteve sociale, mesazhi me këtë përmbajtje e administruar si prove nuk përmban as rrjetin social me të cilin është dërguar, personi që ka dërguar e as numri i telefonit i dërguar nga kush është dërguar, veta pala e dëmtuar ne një deklaram shume konfuzë të cilën gjykata duhet që të mos fal besimin në rastin e vlerësimit të provave, nuk ka qene në gjendje të sqaroj se nga kush është marr ky mesazh dhe nga cili telefon është dërguar, duke pretenduar gjithmonë se e ka mesazhin në origjinal në telefonin e dërguar por asnjëherë nuk është prezantuar në gjykatë, kjo gjendje faktike e vërtetuar bazuar edhe ne raportin e postes si dhe sqarimet e dhëna nga përfaqësuesi S.Th., , padyshim është vërtetuar se pas kidnapimit të vajzës, i njëjti ka dërguar një mesazh nga numri i tij të telefonit, e qe përputhet me kohen e mesazhit te administruar si prove me përmbajtje ofenduese fakt të cilin nuk e ka mohuar as vet i akuzuari. Ndërsa mesazhet kërcënuese nuk i ka dërguar asnjëherë i akuzuari të dëmtuarit, çështja e raporteve familjare ne padyshim përgjegjësia e prindit për tu kujdesur për vajzën 15 vjeçare, dhe bindja e prindit për mos vazhdimin e kësaj lidhje të vajzës në këtë moshe me një person për personalitetin e të cilit veç ka pasur informacione ka mundur të jetë reagim normal i një prindi në këto rrethana, mirëpo asnjëherë çfarëdo raporti kërcënues i cili do të kishte pasoje shkaktim i ankthit dhe frikës te pala e dëmtuar, përfundimisht i ka propozuar gjykatës, që pas vlerësimit të provave të administruara të akuzuarin J. ta liroj nga përgjegjësia penale në mungesë te te provuarit se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën edhe akuzohet.

I akuzuari J:A., në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, duke shtuar se si do të ndiheshit ju kur dikush do t’ju grabit vajzën, do t’ju rrah vajzën, dhe pas kësaj ajo ishte e shtrirë një javë në spital, ashtu që si do të ndiheshit edhe ju po të ishit në vendin tim si prind.

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe paraqitjes dhe shqyrtimit të provave secilës veç e veç e dhe lidhjes logjike të gjithave së bashku ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 16.06.2022, rreth orës 02:00, nga fshati Skorobisht K. Prizren, respektivisht përmes rrjeteve sociale, seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë se do ta privojë nga jeta dhe se do t'i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, me qëllim të frikësimit, në atë mënyrë që për shkak të problemeve lidhur me lidhjen e mëhershme në mes vajzës së të pandehurit, A.A., dhe të dëmtuarit B., A, i pandehuri dërgon mesazh përmes rrjetit social, duke u drejtuar me fjalët “do të të vras, do të shkatërroj jetën”, me ç`rast i pandehuri tek i dëmtuari shkakton frikë, ankth dhe pasiguri personale për jetën e tij dhe anëtarëve të familjes së tij.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor dhe atë nga deklarimi i të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit B., A., të dhënë me datën 09.02.2023, deklarimi i dëshmitarit S. A., të dhënë me datën 18.01.2024, deklarata e ekspertit të operatorit Vala 900 S.Th., të dhënë me datë 06.12.2023, leximin e deklaratës së të dëmtuarit/dëshmitarit B., A., të dhënë në polici me datën 17.06.2022, leximin e deklaratës së të pandehurit J.A., të dhënë në polici me datën 29.06.2022, raportit të dorëzuar gjykatës me shkrim (CD) të datës 14.06.2023 për hyrje daljet të Operatorit telefonik “Vala”, shikimi i foto mesazheve telefonike të dërguara nga i pandehurit tek i dëmtuari.

Deklarimi i dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor.

I dëmtuari-dëshmitari B., A., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 09.02.2023, lidhur me këtë rast deklaroi se qëndron pranë deklarimeve të dhëna më parë në polici, dhe ka theksuar se me të akuzuarin kanë probleme që nga vera e vitit 2022, se nga mosmarrëveshja lindi një problem ku ata – J.i –filloi të më kanos e më pas me kanë kanosur edhe familjarët e tij sepse isha në një lidhje me vajzën e të akuzuarit J., fillimisht nëna e A. A., filloi të më dërgoj mesazhe përmes mesengjerit me ka shkruar se do te kem probleme nëse shkoj pas vajzës A., mirëpo A. ishte ajo e cila vinte pas meje, familja e A. nuk e ka lejuar që të takohet me mua dhe filluan të më kërcënojnë përmes mesazheve në anën tjetër, nëna e vajzës A., që quhet Enisa Alija, e ka njoftuar bashkëshortin e vet, këtu të akuzuarin J. dhe më pas J.i më ka kanosur me mesazhe në numër të SMS-ave, duke me shkruar se më ke ofenduar bashkëshorten dhe do të kesh probleme me mua nëse vazhdon ti shkruash bashkëshortes sime, pas 10 minutave e ka thirr edhe babain tim dhe i ka treguar këto fjalë të njëjta, babai im i ka kërkuar falje dhe me ka pyetur a e kam kryer këto veprime, unë kam treguar mesazhet e mia babait tim dhe pas kësaj përsëri A. me nënën e saj filluan të më përqeshin pse babai im i ka kërkuar falje. Më tej ka pohuar se është e vërtetë se me datë 16.06.2022, rreth orës 02:00 pas mesnatës kam marr mesazhe kanosës se do të më vrasin, do të më shkatërrojnë jetën, dhe duke me share mua dhe familjen. Nuk më kujtohet saktë, se mesazhin e kam marr nga ana e vajzës, nënës së tije apo të akuzuarit, se ky mesazh me është dërguar me celular dhe e kam bërë kopje dhe të njëjtin mesazh në polici kur e kanë fotografua, ata kanë fotografuar vetëm tekstin, nuk e kapën as datën e as numrin, ky mesazh më është dërguar përmes SMS, këtë mesazh e kam tek babai im, ngase telefonin tim ia kam dhënë babait e unë kam tjetër telefon. Mesazhet janë dërguar nga telefoni dhe numri i A., ndërsa se kush i ka shkruar nuk e din. Më tej ka theksuar se e kam bllokuar numrin nga kanë ardhur sms dhe se ndihet i frikësuar, e ka edhe një rast tjetër në polici të lajmëruar ku jam kanosur nga daja e vajzës – A.. Me A., ka qenë në lidhje rreth 10 muaj.

Nga deklarimi i të dëmtuarit- dëshmitarit B., A., gjykata ka vërtetuar këto fakte, se në ditën kritike ka ndodhur kanosja ndaj të dëmtuarit nga i akuzuari, kanosja ka qenë serioze dhe e drejtuar drejtë të dëmtuarit B., A., i cili në ditën kritike përmes sms të shkruar me fjalët kanosëse “ se do të vras, do të më shkatërrojnë jetën, duke i share edhe familjen” ka pësuar shqetësim, frik dhe pasiguri. Motivi i kësaj ngjarje sipas dëshmitarit ishte për shkak të të një lidhjes së dashurisë që i njëjti e kishte me vajzën e të akuzuarit J., A. A., Gjykata këtë deklaram

e vlerëson mjaft të sinqertë dhe të drejtë lidhur me sqarimin e fakteve të cilat kundërshtohen nga i akuzuari, se ky deklaram është në përputhje të plotë edhe me deklarinim që ka dhënë pranë organeve të policisë.

Dëshmitari S. A., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.01.2024, lidhur me rastin deklaroi se të akuzuarin J.A., e njeh, edhe më herët e ka njohur ngase punon me parket ndërsa Jasemini me qeramik dhe gjatë punës sonë jemi njohur. Më tej i njëjti ka pohuar që është e vërtetë që djali im B., A., më ka treguar që gjatë vitit 2022 është kërcënuar nga z.J.A.,. Se arsye nuk e ka ditur edhe pse në fillim nuk i ka besuar djalit, nuk ka besuar kërcënimin e J.it, por personalisht e ka dëgjuar se si J.i nëpërmjet telefonit e ka sharë djalin e tij me nënë dhe familjen, dhe e ka ofenduar, e gjith kjo se djali im dhe vajza e J.it kanë pasur një lidhje dashurie, vajza e J.it këtu shume here ka ardhur në shtëpinë time dhe unë kur e kam pare për here të parë kur ka ardhur, unë e kam pasur numrin e telefonit të J.it dhe e kam thirr në telefon dhe i kam thënë se vajza jote gjendet te unë në shtëpi, kjo ka qenë në vitin 2022, nuk i kujtohet data e saktë, dhe i ka thënë J.it vajza jote është tek unë në shtëpi dhe unë dëshiroj që të bisedoj me ju J., i kam thënë edhe atë se vajza e tij ka dëshiruar që unë të bisedoj me J.in, ku ne atë kohe ne ishim ne marrëdhënie të mira shoqërore, unë shkova te J.i, u takova me të jashtë shtëpisë se tij, tek As Petroli në Lubizhde, dhe gjate bisedës unë i kam thënë J.it, ti ke një vajzë, unë kam një djalë, nuk e dua padrejtësinë dhe kam ardhur të bisedoj si njeri me ty. Ku pas kësaj te pompa e benzinës erdhën djali dhe vajza e J.it, te cilët ishin të pandarë dhe nuk kemi mundur ti ndajmë prej njeri tjetrit, kemi pas një bisedë të këndshme dhe në fund para se të ndahemi vajza e J.it ka hyrë në veturën time dhe nuk ka dashur të dal prej veturës, sepse vajza e J.it dhe djali im ishin te pandashëm, ku vajza e J.it i ka thënë bashkëshortes time se në shtëpi e kanë rrahur, i ka dërguar mesazhet ku ne i kemi datat dhe mesazhet dhe unë i kam lutur që mos ta rrahin prindërit e vajzës kurse J.i mu ka përgjigjur është shume e re dhe nuk mund te kujdeset për vete e leje më te marrohet, pastaj unë jam përgjigjur edhe djali im i ka mbushur 18 vjet, d.m.th ata kane hyre në një lidhje para se biri im të mbush 18 vjet. Më tej ka theksuar se me dt.16.06.2022, e ka parë një mesazh kërcënues dhe në fund me sharje në telefon, telefoni fillimisht ka qenë i djalit të tij, pastaj këtë telefon e ka marr vet, kurse djali i tij e ka ndërruar numrin e telefonit në mënyre që mos të ketë kontakt me J.in, se djali i ka treguar se J.i me ka dërguar këtë mesazh, në numrin e telefonit të vjetër që e ka pasur djali im, numrin nuk e di por nëse me jepet ta shikoj sms-in do të më kujtohet, edhe pse ka kaluar një kohë më kujtohen fjalët kërcënuese që i ka thënë djalit tim B.,it ‘më ke ofenduar bashkëshorten time gruan e J.it dhe kjo nuk ka me dal mire se ka mu bo një pune e madhe, këtë do te tregoj edhe S.it dhe aty ka shënuar se e ka sharë B.,in dhe familjen e tij krejt “jebaçu ti sve zhivo (kam me ti q... krejt te gjallët), “do ta shkatërroj jetën, do të vras dhe do ta shkatërroj jetën idiot”, mesazhin e ka parë kur ja ka treguar djali i tij B.,i, që ia kishte dërguar J.i, dhe ka theksuar se këto mesazhe kanë ardhur në numrin e telefonit të djalit tim. Më tej prokurori i çështjes i ka dhënë në shiqim dëshmitarit faqen 15-16 të kallëzimit penal që ti lexoj sms, dëshmitari ka pohuar që po këto mesazhe i ka parë, dhe se ia ka treguar djali i tij nga telefoni, dhe këto mesazhe i ka lexuar vet, këto mesazhe kanë ardhur nga J.i, por nuk e din datën e saktë të ardhjes së tyre. Më tej për raportet tani me Jaseminin, ka theksuar se J.i e din se gjithmonë kam treguar gatishmërinë edhe tash tregoj gatishmëri dhe i ka mesazhet që unë i kam dërguar J.it për pajtim dhe mirëkuptim, dhe unë jam personi me i dëmtuar në këtë rast. Dëshmitarit poashtu gjatë deklarinimit i është dhënë në komunikim numri i telefonit të djalit të tij dhe pasi e shikoj numrin në mesazh tha po ky është numri i telefonit të djalit të tij dhe atë

Nga deklarimi i dëshmitarit S. A., gjykata ka vërtetuar rrjedhën e ngjarjes e cila ka ndodhur në ditën kritike prej fillit të problemit në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit që lidhet me ditën kritike, pasi që i njëjti është prindi –baba i të dëmtuarit, i njëjti i ka parë sms të cilat i

ka treguar i biri, fjalët kanosëse duke ditur paraprakisht problemet mes tyre. Dëshmitari në deklarin e tij e ka përshkruar motivin dhe ngjarjen se si ka rrjedhur prej momentit kur djali i tij kishte shkëputur lidhjen me vajzën e të akuzuarit A., pasi kishte probleme me prindin e saj J.in, ku ditën kritike me datë 16.06.2022, e ka parë një mesazh kërcënues - fjalët kërcënuese që i ka thënë djalit tim B.,it "më ke ofenduar bashkëshorten time gruan e J.it dhe kjo nuk ka me dal mire se ka mu bo një pune e madhe, këtë do te tregoj edhe S.it dhe aty ka shënuar se e ka sharë B.,in dhe familjen e tij krejt "jebaçu ti sve zhivo (kam me ti q... krejt te gjallët), "do ta shkatërroj jetën, do të vras dhe do ta shkatërroj jetën idiot". Deklarimit të dëshmitarit, i cili ka qenë së bashku me të dëmtuarit në ditën kritike gjykata ia falë në tërësi besimin, se një deklarin i tillë është në përputhje të plotë edhe me deklarinet e të dëmtuarit dhe dëshmitarit Lulzim Krasniqi, pjesërisht me deklarinin e të pandehurit dhe mbrojtjen e tij dhe deklarinet e mëparshme në polici dhe prokurori.

Nga deklarata e ekspertit të operatorit Vala 900 S.Th., të dhënë me datë 06.12.2023 në shqyrtim gjyqësor ka theksuar se pasi qe u informova nga gjykata dhe e mora një kopje të raportit Vala 900, jap të dhënat sipas këtij raporti. Për datën 16.06.2022 se a ka pasur ndonjë komunikim me sms në mes numrave të telefonit në drejtim të numrit, ka shpjeguar se është dërguar vetëm një sms nga numri, në drejtim të numrit, në ora 22:55 min, figuron në faqen 3 të raportit, komunikime të tjera nuk ka pasur me datë 16.06.2022 në ora 02:00 të mëngjesit. Poashtu ka theksuar se sipas njohurive të tija si zyrtar i PTK-së, tekstet e sms nuk ruhen dhe një tekst i tillë nuk mund të sigurohet për gjykatën. Sa i përket dërgimit të sms nga një numër tek një tjetër, të njëjtat regjistrohen në databazë për të cilën keni raport, dhe nuk mund të ndodh ndonjë gabim teknik. Nga shikimi i raportit nga zyra ligjore e operatorit të telefonisë mobile "Vala 900" në faqen e 3, shihet se ka pasur thirrje telefonike me biseda nga numri në drejtim të numrit dhe atë në ora 23:06 min, 23:09 min, 23:10 min.

Nga ky deklarin i ekspertit të operatorit telefonik "Vala" dhe sipas raportit të dorëzuar gjykatës me shkrim (CD) të datës 14.06.2023, për gjykatën është vërtetuar se ditën kritike me datë 06.12.2023, ka pas thirrje telefonike dhe dërgim të një sms mes numrit në drejtim të numrit

Leximi i deklaratës së të dëmtuarit/dëshmitarit B., A.,

Nga leximi i deklaratës së të dëmtuarit/dëshmitarit B., A., të dhënë në organet e ndjekjes në polici me datën 17.06.2022, është vërtetuar se i njëjti ka theksuar se me vajzën e të akuzuarit J.A., A., ka qenë në një lidhje dashurie rreth një(1) viti, dhe rreth tre muaj të fundit ka pasur problem me babain e saj të akuzuarin J., dhe meqë gjatë kësaj periudhe ka pasur problem me të akuzuarin J., nuk ka dashur të takohet me A., dhe ka pasur kërcënime të ndryshme, saktësisht me datë 16.06.2022, i akuzuari përmes telefonit e ka kanosur se do ta vras dhe do ti shkatërroi jetën, si pasoj ka paraqitur rastin në polici.

Deklarimi i të dëmtuarit B., A., në polici për gjykatën është e besueshme sepse i dëmtuari i ka përshkruar fjalët kanosëse ndaj tij, sikurse edhe në procedurat të tjera gjyqësore, duke përkuar me rrethanat e rastit. Po ashtu edhe nga administrimi i provave materiale mbështetet deklarin i të dëmtuarit.

Nga leximi i deklaratës së të pandehurit J.A., të dhënë në organet e ndjekjes në polici me datën 29.06.2022, i njëjti ka theksuar se me të dëmtuarin B., A., e ka takuar vetëm dy herë në jetë, me të njëjtin ka mosmarrëveshje ngase i njëjti i ka kidnapuar vajzën e tij, të cilën e ka vozit njëzet kilometra ku e ka rrahur, ka mohuar ta ketë kanosur të dëmtuarin përmes mesazheve telefonike, përveç një natë ku pasi ia ka rrahur vajzën, i ka shkruar një mesazh ku e

ka shar, ndërsa nuk e din që dikush nga familja e tij ta ketë kanosur përmes telefonit të dëmtuarin, se vajza e tij është vetëm 16 vjeçare, me bashkëshorten e tij asnjëherë nuk e kishin aprovuar lidhjen e vajzës së tij me të dëmtuarin ngase i njëjti është i dhunshëm, përdor edhe drogë dhe se nuk do ta lejojnë këtë lidhje.

Nga deklarimi i të akuzuarit gjykata ka vërtetuar se deklarimi i tij është i njëjtë me mbrojtjen e tij gjatë procedurave të mëtutjeshme, por jo i besueshëm për gjykatën ngase shkon në drejtim të ikjes së përgjegjësisë penale.

Nga shikimi i foto mesazheve telefonike të dërguara nga i pandehurit tek i dëmtuari, gjykata ka vërtetuar faktin se në drejtim të numrit +..... (që ditën kritike i ka takuar të dëmtuarit B A.), është dërguar teksti (sms) me fjalët ‘‘Ane, çë te ubijem, zhivot çë ti unishtim, zhivot çë ti unishtim bre idiote jedan (Ane kam me të vra, kam me ta shkatërrua jetën, bre idiot), të vërtetuara edhe me sjelljen e telefonit fizikisht gjatë seancës.

Përfundimet mbi faktet vendimtare (provat).

Pas administrimit të gjitha provave në shqyrtimit gjyqësor dhe leximin e provave materiale gjykata gjeti se i akuzuari J:A., është fajtor për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.1 të KPPRK-së, përfundimi i gjykatës se i akuzuari është fajtor për veprën penale të lartcekur, fajësia e të akuzuarit është vërtetuar nga administrimi i provave sidomos nga deklarimi i të dëmtuarit B., A.,, dëshmitarit S. A.,, deklarimi i vetë të akuzuarit i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor mbrojtjen e tij e ka orientuar vetëm lidhur me faktin se të dëmtuarin nuk e ka kanosur me asnjë fjalë, megjithëse ka pranuar se kanë pasur mosmarrëveshje për shkak të lidhjes së dashurisë së të dëmtuarit me vajzën e tij, ku të njëjtit i ka dërguar sms në formë të sharjes – ofendimit por jo në kuptim të mesazhit kërcënues. Edhe për të akuzuarin sipas bindjes së kësaj gjykate nuk ishte papranueshme se me të dëmtuarin kishin pasur mosmarrëveshje rreth lidhjes së vajzës së tij A. me të dëmtuarin, se i njëjti i cili nuk pajtohet me këtë lidhje pasi që i njëjti e ka rrahur vajzën e ka kidnapuar dhe se i njëjti është përdorues i substancave narkotike, nuk e mohon as faktin se i ka dërguar mesazh të dëmtuarit me përmbajtjen ‘‘ jebaçu ti sve zhivo’’ (ka me ti qi të gjithë të gjallë),. Mirëpo sipas bindjes së kësaj gjykate e për të akuzuarin ishte e papranueshme se ka ndërmarr fjalë kanosëse ‘‘ka me të vra do ta shkatërroj jetën’’ në drejtim të këtu të dëmtuarit. Gjykata këto fakte të kundërshtuara nga i akuzuari i sheh si tentim për të ju shmangur përgjegjësisë penale, për faktin se me administrimin e provave është vërtetuar gjendja faktike apo tërësia e të gjitha fakteve të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, prandaj faktin se i akuzuari me të dëmtuarin, ka pasur mosmarrëveshje dhe i ka dërguar vetëm sms –mesazh në formë të ofendimit sharjes, por mohimi i tij se nuk i ka thënë fjalë kanosëse nuk mund të qëndrojë sepse nga deklarimi i të dëmtuarit dhe dëshmitarit si dhe vetë të akuzuarit është vërtetuar se i akuzuari J. ka dërguar fjalët kanosëse përmes sms të shkruar në drejtim të dëmtuarit B., A.,, këtë fakt e vërtetoi gjykata edhe me provat mbështetëse siç ishte sjellja e telefonit gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor ku në telefonin mobil me numri +..... (që ditën kritike i ka takuar të dëmtuarit B A.), është teksti (sms) me fjalët ‘‘Ane, çë te ubijem, zhivot çë ti unishtim, zhivot çë ti unishtim bre idiote jedan (Ane kam me të vra, kam me ta shkatërrua jetën, bre idiot) , mbështetur edhe nga dëshmia e ekspertit të operatorit Vala dhe raportit zyrtar të tyre, të cilët vërtetuan që ditën kritike mes të akuzuarit dhe dëmtuarit ka pasur disa komunikime dhe një sms të dërguar. Lidhur me këtë fakt se i akuzuari e ka kanosur me sms e lartcekur të dëmtuarin duke i shkaktuar shqetësim, frikë dhe pasiguri, janë vërtetuar po ashtu nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga deklarimi i të dëmtuarit dhe dëshmitarit S. A., të cilit i ka komunikuar i dëmtuari për fjalët kërcënuese dhe të njëjtin sms i njëjti e posedon edhe sot në telefonin e tij.

Mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor.

I akuzuari J.A., në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 12.02.2024 ka dhënë mbrojtjen e tij lidhur me aktakuzën e prokurorisë themelore në Prizren, ku ka deklaruar se me datën 16.06.2022, ka qenë me familjaret në fshatin Mushnikovë, B., i ka kidnapuar vajzën time duke e futur me forcë në veturë, dhe e ka vozitur 20 km larg, ku dhe e ka rrahur, për këtë e ka njoftuar djali i tij ku pas 5 minutave e kam takuar vajzën ajo mi ka treguar të gjitha duke qar, e ka thirr në telefon B., in, megjithëse ai nuk është lajmëruar në telefon, pas kësaj i ka dërguar një mesazh në kuptim të mesazhit jo kërcënues por si ofendim ose sharje. I kujtohet se mesazhi i është dërguar rreth 23:00, me përmbajtje, (jebaçu ti sve zhivo), (kam me te qi të gjithë të gjallë), ky është mesazhi i vetëm që kam dërguar me datë 16.06.2022 dhe asnjë mesazh tjetër nuk ia kam dërguar, mesazhet tjera të cekura janë shkruar rreth 2 muaj më herët. Më tej ka theksuar se B., in e ka njohur pasi që ai ka qene në lidhje me vajzën time, kur ka dëgjuar që është ai një fëmijë pa edukuar dhe është rrahur me të gjithë, dhe ka përdorur substanca narkotike, ishte kundër kësaj lidhjeje. Që nga data 16.06.2022, personalisht nuk jam takuar me B., in, por ai sa here qe me ka takuar, ka bere shllajf-me vrull dhe me ka provokuar. Ka mohuar që me datë 16.06.2022 në ora 02:00 të mëngjesit ti ketë dërguar mesazhe kërcënuese , nëpërmjet rrjeteve sociale, të dëmtuarit B.,, me përmbajtje, (ubiçute unishtiçu zhivot), kam me te vra, do te shkatërroj jetën. Më tej ka theksuar se nuk kanë pas probleme familjare me ata, por ishte i detyruar që të vendosi lidhur me vajzën e tij, sepse ajo i kishte vetëm 15 vjet dhe ishte e mitur, me të dëmtuarin personalisht nuk është takuar, vetëm në prezencën e prindërve të tij, dy muaj më herët se data kritike, ku ju ka thënë, që vajza ime nuk është për martese, para se ta kryen shkollën e mesme. Ndërsa për mesazhet të tjera kërcënuese në drejtim të të dëmtuarit, ka thënë se meqenëse ai nuk ka pasur probleme vetëm me mua, ashtu qe nuk e di se kush kishte mundur ti dërgoj atë mesazh me përmbajtje kërcënuese, sepse ai ka edhe vepra tjera penale të cilat i ka kryer dhe po gjykohe.

Deklarimin e të akuzuarit gjykata e merr si pjesërisht të besueshëm për faktin se i njëjti është në kundërthënie me vetveten për faktin se thotë që ditën kritike nuk i ka dërguar mesazhe me përmbajtje kërcënuese të dëmtuarit, ndërsa pranon se i ka dërguar një sms (mesazh) të vetëm me përmbajtjen ofenduese (jebaçu ti sve zhivo), (kam me te qi të gjithë të gjallë) dhe se me të njëjtin kishin probleme pasi që i kishte kidnapuar dhe rrahur vajzën. Për gjykatën deklarimi i tij është në kundërshtim me të gjitha provat direkte dhe materiale, prandaj kjo gjykatë nuk mund ti jap besimin një deklarimi të tillë sidomos kur kemi parasysh se i njëjti gjatë deklarimit të tij, që nga fillimi është munduar që ti shmang fakte që lidhën me këtë çështje penale.

Analizimi i veprës penale

Nga administrimi i provave dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata erdhi në përfundim se i akuzuari J.A., është fajtor për veprën penale, Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së. Kualifikimi i kësaj vepre penale rrjedhë si pasojë e veprimeve dhe pasojave të shkaktuara nga i akuzuari, prandaj nga rrethanat e rastit konkret meqenëse është vërtetuar edhe gjendja faktike sipas aktakuzës së prokurorisë themelore në Prizren, rezulton se i dëmtuari B., A., ka përjetuar shqetësim, frikë dhe pasiguri, nga fjalët kanosëse që i janë bërë nga i akuzuari. Prandaj me veprimet e të akuzuarit dhe pasojat që janë shkaktuar tek i dëmtuari formohen të gjitha elementet e veprës penale Kanosja nga neni 181 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, e cila thotë që *“Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te*

personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj’ Ndërsa par. 2 thotë ‘Kushdo që seriozisht i kanoset personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ta privojë nga jeta ose se do t’i shkaktojë lëndim të rëndë trupor, se do ta rrëmbejë ose privojë nga liria ndonjë person tjetër ose se do ta dëmtojë me armë zjarri, me shpërthim ose me mjete të tjera të rrezikshme, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një (1) vit.

Prandaj sipas bindjes së gjykatës nga analizimi i kësaj dispozite del se me faktin se në këtë rast janë përdorur fjalët kanosëse me të cilat mund të shkaktohet ndonjë e keqe me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit për jetën dhe shëndetin e të dëmtuarit B., A., është e mjaftueshme për të arsyetuar kryerjen e kësaj vepre penale, të cilën e ka kundërshtuar i akuzuari.

Përcaktimi për llojin dhe lartësinë e dënimit

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit të parapara si në nenin 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanë lehtësuese mori parasysh sjelljen korrekte të të akuzuarit gjatë procedurave gjyqësore. Si rrethana rënduese në rastin konkret për të akuzuarin J.A., gjeti shkallën e lartë të pjesëmarrjes dhe të dashjes ku i akuzuari ka vepruar me dashje direkte ka mundur ta dijë se me veprimet e tija mund të kryente vepër penale, motivin e veprës penale e cila ka ndodhur si pasojë e probleme në mes të dëmtuarit dhe të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 449 dhe 451 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike është marr konform nenit 457 të KPPK-së

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 813/2022 me datë 12.03.2024

B. profesional
Arbnijë Gashi

Gjyqtari
Fatmir Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë(30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate T